

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA, 2021–2025, DHE PLANIN E VEPRIMIT 2021–2022”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i këtij projektvendimi ka si qëllim ndryshimin e Vendimit nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2021–2022”, të ndryshuar, si një instrument për të mbledhur të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe partnerët ndërkombëtarë, në një dakordësi mbi situatën e trafikimit të personave, sfidat e hasura dhe mënyrat e mjetet për t’i përballuar ato.

Trafikimi i personave vijon të mbetet një fenomen shqetësues jo vetëm për Shqipërinë por edhe për vendet e rajonit si dhe vendet e BE-së, ndaj për luftimin dhe goditjen e tij është e domosdoshme që të ketë një përgjigje ndërsektoriale, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse nga të gjithë aktorët, shtetëror dhe joshtetëror kombëtarë dhe rajonal, të cilët duhet të ndërveprojnë në mënyrë të koordinuar dhe efektive

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 është dokumenti më i rëndësishëm politik kombëtar i cili koordinon aktorët shtetërorë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e personave. PKV është një shprehje e qartë e vullnetit të Qeverisë Shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme të karakterit institucional, ligjor dhe buxhetor për t’iu përgjigjur në mënyrë të koordinuar trafikimit të personave.

Bazat e ndëryrjeve dhe veprimeve të përcaktuara në PKV-ë mbeten parandalimi, hetimi dhe ndjekja, mbrojtja dhe riintegrimi social dhe ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit.

Ky dokument është vazhdim i objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, por të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Gjithashtu, ky projektakt është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2024, në katërmujorin II, si një nga masat për përmbushjen e detyrimeve nën kapitullin 24, ndaj miratimi i këtij projektvendimi, do të plotësojë realizimin e angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar dhe ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Plani bazohet edhe në raportin e monitorimit të tij për të krijuar vijueshmëri dhe reflektuar në mënyrë adekuate masat e përcaktuara dhe ato të realizuara pjesërisht si edhe për të përfshirë dhe përpunuar masa të cilat janë raportuar të realizuara por që konsistojnë në objektiva e veprimtari të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve dhe financimi i tyre i përshtatshëm. Gjithashtu, dokumenti reflekton gjetjet e rekomandimet e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje me situatën e trafikimit si dhe rekomandimet e sugjeruara me qëllim përmirësimin e situatës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Brendshme, vlerëson të domosdoshme miratimin e Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025, për faktin se trafikimi i personave:

- është një fenomen kompleks, që shkon përtej luftës kundër krimin të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;
- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;
- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përjasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale.

Plani Kombëtar i Veprimit, i propozuar për miratim, pas paraqitjes së një analize të përgjithshme mbi situatën aktuale të trafikimit në Shqipëri identifikon faktorët

vendimtarë që qëndrojnë në themel të trafikimit, si dhe grupet më të prekura të shoqërisë, si: fëmijët, vajzat, gratë dhe komunitetet etnike Romë dhe Egjiptianë. Krahas renditjes së disa prej arritjeve më të rëndësishme gjatë periudhës 2018-2020, në Planin e Veprimit identifikohen si fusha që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani:

- Garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesimi në drejtësi);
- Përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtim të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimit të të drejtave të viktimave të trafikimit;
- Sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktimat apo viktimat të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të);
- Garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit, për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të;
- Garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore), si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve;
- Nxitja e kthimit dhe ri-integritimit, përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar dhe ritrafikuar, ose që të kthehen në trafikues;
- Përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, etj.) si dhe pasojat e tij;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar;
- Bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe veçanërisht me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror dhe lokal;

- Përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e personave, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni se, trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktime apo viktime të mundshme të trafikimit. Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një riintegrim afatgjatë në shoqëri.

Duke miratuar këtë Plan Veprimi, të gjithë aktorët angazhohen të sigurojnë zbatimin e detyrave të përfshira në këtë dokument dhe nën përgjegjësinë e tyre përkatëse, përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, në të cilin ndër të tjera përcaktohet se: “*Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore*”, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”, i ndryshuar, si dhe është hartuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara apo konventa, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVEKNDIMIT

PKV-ja bazohet në vizionin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe, në veçanti, synon të sigurojë që qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë janë të angazhuar dhe përkushtuar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave dhe për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe grupeve vulnerabël nga trafikimi, marrjen e masave efektive ligjore ndaj autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht, fëmijëve e grave.

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni, se trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit.

Ky vizion është në përputhje dhe me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 “*Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë*”, në lidhje me objektivat e parashikuar për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë, uljes së trafikimit të paligjshëm dhe në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Misioni i PKV-së është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndërinstytucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen së shoqërisë civile dhe komunitetit

Parimet e Planit Kombëtar të Verpimit janë:

- ***Përgjegjësia shtetërore:*** shteti ka përgjegjësi të marrë masa për të reaguar dhe përgjigjur ndaj situatës së trafikimit në kohë, me efektivitet, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.
- ***Respektimi i të drejtave të njeriut është konsideratë parësore:*** të drejtat e personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar e luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht te të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave dhe veçanërisht te viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

- ***Sigurimi i mbështetjes efektive të viktimave të trafikut/viktimave të mundshme të trafikut:*** mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit bazohet në një qasje holistike, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të përshtatur nga pikëpamja kulturele, që ka në qendër viktimat dhe konsideron efektet e traumës.
- ***Qasja ndërinstitucionale:*** të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetëror të përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, bashkëpunojmë në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat/detyrimet e këtij Plani Veprimi.

Plani Kombëtar i Veprimit ruan ato elementë të vlerësuar si pika më të forta në luftën kundër trafikimit, por edhe duke u përditësuar me një përjasje të re në përgjigje të nevojave dhe kontekstit të ri në të cilin ndodhemi. Në këtë Plan Veprimi janë ruajtur elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e agjencive shtetërore dhe joshtetërore, si dhe shtrirjen e veprimit të tij në të gjithë territorin e vendit, duke e vënë theksin sërish në forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, bazuar edhe në reformën e re territoriale-administrative.

Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024 – 2025 është hartuar sipas Vendimit nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)” dhe është bazuar në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, ndarë në këto qëllime të politikës:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me objektiv specifik dhe masë prioritare:

- 1.1 Goditja e trafiqeve të paligjshme;
 - 1.1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar;
 - 1.1.2 Forcimi i kapaciteteve të sktrukturave të drejtësisë dhe Policisë së Shtetit për hetimin proaktiv, ndjekjen penale, dënimin dhe sekuestrimin e pasurive të trafikantëve;
 - 1.1.3 Shkëmbimi i infomacionit dhe kordinimi ndërinstitucional i strukturave përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, me objektiva specifikë:

- 2.1 Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar;
 - 2.1.1 Rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit";
 - 2.1.2 Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse përkatëse për nevojat e tyre;
- 2.2 Rritja e profesionalizmit

2.2.1 Rritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me objektivat specifik:

3.1 Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar;

3.1.1 Shperndarja e informacionit mbi trafikimin e personave;

3.1.2 3.1.2 Mase prioritare: Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të personave;

3.1.3 Gjithëpërfshirja e shoqërisë dhe institucioneve.

3.2 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/ huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

3.2.1 Hartëzimi i nevojave për mbështetje nga partnerët kombëtar dhe Ndërkombëtar

3.2.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe koordinimi me partnerët

Në thelb, aktivitetet e parashikuara në PKV 2024-2025 kanë si synim të përmirësojnë funksionimin e një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegritit të viktimave të trafikimit. Ky plan veprimi është në përputhje me zhvillimet e fundit kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkesat dhe detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku vendi ynë bën pjesë. Aktivitetet në këtë Plan Veprimi janë konkrete, të zbatueshme dhe të matshme, me tregues të mirëpërcaktuar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Plani i Veprimit angazhon me detyrime një numër të gjerë institucionesh dhe agjencish shtetërore dhe joshtetërore, duke u bazuar në përgjegjësitë, detyrimet dhe kontributin e secilës prej tyre në parandalimin e trafikimit të personave dhe garantimin e një mbrojtjeje gjithëpërfshirëse për viktimat e trafikimit. PKV ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërore dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë, ku rol më të spikatur ka Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshin një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë, si: Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe

Turizmit. PKV është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë jo-shtetërorë që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jo-fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Detajimi i këtij Plani Veprimi sjell si risi, vendosjen e lidërshipt, marrjen e përgjegjësisë shtetërore në kostimin e aktiviteteve nga secili institucion, entitet apo strukturë dhe një qasje të integruar multidisiplinare të agjencive shtetërore dhe veçanërisht të strukturave të vetëqeverisjes vendore në adresimin e çështjes së trafikimit të personave. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Gjithashtu, Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 do të zbatohet edhe nga institucionet e pavarura të cilat kanë një rol të veçantë në çështjet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën antitrafikim, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Duke ndjekur procesin e vlerësuar si tepër të suksesshëm të hartimit të Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, edhe hartimi i Planit aktual ka kaluar në një proces gjithëpërfshirës, konsultativ të realizuar nga Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin me anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe të Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Personave si edhe me mbështetjen me ekspertize tekike të OSCE.

Pjesëmarrësit kanë dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre qoftë në takimet e zhvilluara, ashtu dhe në format elektronik.

Ky dokument është konform vizionit të qeverisë, reformave të ndërmarra në fushën e antitrafikut si dhe detyrimeve në kuader të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, proceseve rajonale dhe ndërkombëtare.

Për hartimin e PKV-së janë analizuar dhe marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare për sa i përket situatës së trafikimit të personave në Shqipëri dhe, konkretisht: Progresraporti i BE-së, Këshilli i Evropës (GRETA), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat dhe Raporti Global i Departamentit Amerikan të Shtetit, për Trafikimin e Personave.

Procesi i hartimit të dokumentit ka kaluar në një proces konsultimesh me anëtarë të komiteteve rajonale antitrafik të qarqeve Tiranë, Kukës, Dibër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit kundër trafikimit të personave 2024 – 2025”, është rreth 276.5 milionë Lekë, ose rreth 2.5 milionë Euro. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 110 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 2 viteve të zbatimit të Planit të veprimit 2024 - 2025.

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia Kostove	Kostoja Totale e 2024-2025	Kostot Planifikuara PBA 2024-2025 Buxheti Donator	^e Kosto për tu Planifikuar në & Buxhetin 2026- 2030	Hendeku Financiar 2024-2025
Qëllimi i Politikës 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korente	37,891,894	34,551,894	0	3,340,000
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 2: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË	Korente	66,865,436	52,891,436	0	13,974,000
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 3. RRITJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korente	148,758,088	119,490,088	0	52,268,000
	Kapitale	23,000,000	0	0	
TOTALI [Leke]		276,515,418	206,933,418	0	69,582,000
TOTALI [Euro]		2,513,777	1,881,213	0	632,564
<i>1 euro 110 Leke</i>					

Tabela: Kostot indikative të planit të veprimit “Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit 2024 – 2025”

Për periudhën 2024-2025, shpenzimet e planifikuara në buxhetet e institucioneve përgjegjëse janë rreth 206.9 milionë lekë, të cilat janë planifikuar në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Hendeku financiar për këtë periudhën është 69.5 milionë lekë ose 25.2% e kostove indikative. Për periudhën 2024-2025, buxheti i shtetit pritet të financojë

74.8% të kostove indikative totale të zbatimit të planit për periudhën 2024-2025, ndërsa financimi huaj nuk është identifikuar.

PROPOZUESI

MINISTRI

TAULANT BALLA